

URDHËR
Nr.511, datë 13.10.2011

PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA NË FAZËN E DYTË TË KONKURRIMIT ME FORMULARIN A2, TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012, NËPËRMJET FORMULARIT A3

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2077 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.423, datë 8.6.2011 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2011-2012, si dhe tarifat e shkollimit”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, si edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kuotat e parealizuara, pas mbylljes së fazës përfundimtare të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë për vitin akademik 2011-2012 (raundi i parë i konkurrimit me formularin A2), të shpërndahen sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur.

2. Plotësimin e formularit A3 nga maturantët/kandidatët, të cilët:

a) Nuk kanë arritur të përfshihen në listat e fituesve të fazës së parë dhe të dytë të konkurrimit me formularin A2, dhe për rrjedhojë nuk janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012;

b) Janë shpallur fitues në listën paraprake ose përfundimtare të garës me formularin A2 dhe nuk janë të regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012;

c) Rezultuan mbetës në sesionin e parë të provimeve të Maturës Shtetërore (qershor 2011) dhe arritën rezultate kaluese në provimet e vjeshtës (sesioni i dytë);

d) Janë regjistruar në sesionin e dytë të Maturës Shtetërore 2011 nëpërmjet plotësimit të formularit A1Z dhe rezultojnë kalues në të katër provimet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), DAR/ZA-të dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj